

**PERMBLEDHJE JOTEKNIKE**

**PER PROJEKTIN:**

**"SHFRYTEZIM ME KARRIERE SIPERFAQESORE E  
MINERALIT TE KROMIT"**

**OBJEKTI: "KATJEL"**

**ZONA MINERARE 690/6**

**Vendodhja:** Fshati Rajce Fushe, Njësia Administrative Rrajce, Bashkia Prrenjas, Qarku Elbasan.

**Kërkuar:** Subjekti: "MINERALUNIT" Sh.p.k

Hartoi:

**"ENVIRONMENTAL MANAGEMENT CONSULTANTS" Sh.p.k**

(Çert. Nr. 551 Prot, dt. 24.10.2008)

Administrator

**Elidiana Shehu**

Shtator, 2020

**PËRMBAJTJE:**

1.	PËRSHKRIMI I MJEDISIT .....	3
1.1	Mjedisi fizik.....	3
1.1.1	Gjeologjia.....	3
1.1.2	Morfologjia .....	6
1.1.3	Relievi .....	6
1.1.4	Tokat.....	6
1.1.5	Ujërat.....	7
1.1.6	Klima.....	9
1.2	Mjedisi biologjik .....	9
1.3	Pershkrimi i cilesise se mjedisit dhe ndikimeve e mundeshme.....	12
1.3.1	Cilesia e ujrave.....	12
1.3.2	Cilesia e ajrit .....	14
1.3.3.	Zhurmat.....	15
1.3.4.	Administrimi i mbetjeve .....	16
2.	PERSHKRIMI I PROJEKTIT .....	17
2.1	Qellimi i Projektit.....	17
2.2	Mënyra e shfrytëzimit .....	17
2.3	Regjimi i punës .....	18
2.4	Variantet e hapjes së vendburimit dhe argumentimi dhe zgjedhja e mënyrës së hapjes.....	18
2.5	Sistemi i shfrytëzimit treguesit tekniko-ekonomikë të tyre .....	18
2.6	Elementet e sistemit te shfrytezimit qe parashikohet te perdoret ne kete objekt jane: .....	19
2.7	Rradha dhe drejtimi i shfrytëzimit.....	19
2.8	Mënyrat e rrëzimit të mineralit te kromit në karrierë .....	19
2.9	Rrëzimi i mineralit te kromit në shkallët e karrierës me lëndë plasëse me bira sonde.....	20
2.10	Elementet teknik te frontit te punes ne karrjere .....	20
3.	ANALIZA E NDIKIMEVE TË MUNDSHME SOCIALE DHE NË MJEDIS .....	21
4.	PROGRAMI I MONITORIMIT TË NDIKIMEVE NË MJEDIS GJATË ZBATIMIT TË PROJEKTIT .....	23
5.	NDIKIMET POZITIVE NE MJEDISIN E ZONES SE PROJEKTIT .....	24
6.	PLANI I MASAVE PËR ZBUTJEN E NDIKIMEVE TË IDENTIFIKUARA (PMM) ..	25

## **1. PËRSHKRIMI I MJEDISIT**

### **1.1 Mjedisi fizik**

#### **1.1.1 Gjeologja**

Pozicioni gjeotektonik i rajonit ku ben pjese objekti, i perket zones tektonike "Mirdita. Ne ndertimi gjeologjik te zones marin pjese shkembinje magmatike te cilet ndertojnë pjesen e poshteme te prerjes, xeheroret e Fe-Ni qe vendosen ne pjesen e siperme te prerjes magamatike duke formuar vendburimet e Prrenjasit, Rahtanit e Ktjelit, gelqeroret masive te kretakut te siper dhe mbi keto kemi depozitimet konglomeratike te oligocenit me trashesi mbi 200ml.

Zona e kerkuar per shfrytezim ndodhet ne pjesen qendrore te masivit ultrabajzik te , masiv I cili perbehet nga harzburgitet, dunitet, verlitet, lercolitet, piroksenite dhe serpentinitet, llojet e tyre te fresketa dhe te serpentinizuara. Ne kete masiv shume rralle takohen dhe llojet e shkembinje ultrabajzike me plagioklaz qe perbejne anen kalimtare me shkembinje bazike gabroide.

Rolin kryesor ne shkembinje e permendur me lart e lozin harzburgitet e serpentinizuara. Perhapje me te kufizuar kane dunitet te cilat zakonisht formojne thjera dhe trupa me konfiguracione te shrregullta dhe ne raste te vecanta masive te vegjel. Shkembinje ultarbaziske te rajonit perfaqesohen kryesisht nga Harzburgite, dunate, serpentinitet e serise damarore.

#### **Llojet, stratigrafia dhe mosha e shkembinjeve qe marrin pjese ne ndertimin e rajonit dhe vendburimit**

Shkembinje ultarbaziske te rajonit perfaqesohen kryesisht nga Harzburgite, dunate, serpentinitet e serise damarore.

##### *Harcburgite;*

Harcburgitet zene siperfaqen me te madhe te rajonit. Ata kane tekture masive, strukture te mesme deri te vogel kokrizore. Ne thyerje te fresket kane ngjyre jeshile te erret, deri ne jeshile te zeze. Permbajne rreth 10 – 15 % kristale pirokseni me madhesi nga 1 – 3 m/m, e ne disa raste me te medha. Ne per gjithesi kane shkalle te larte serpentinizimi, sidomos ne pjesen veriore te shfaqjes se kromit ne objektin "Katjel- Zona Minerare 690/6". Ne keta te fundit vihen re edhe cipa te rralla e te holla te mineralizimit sulfur. Harzburgitet vende – vende permbajne pikezime te vogla e te ralla kromshpineliti sidomos ne zonat prane shfaqjeve te mineralizuara kromitike.

##### *Dunitet;*

Dunitet takohen ne forme brezash, siç jane dunitet e takuara ne zonene e Gobilles. Takohen ne forme pllakash te nxjerra edhe nga prishjet tektonike, qe jane me karakteristike ne objektin "Katjel- Zona Minerare 690/6", gjithashtu takohen edhe ne formen e kemishes dunitike.

Dunitet jane masive me strukture te vogel kokrizore. Ne thyerje te fresket kane ngjyre jeshile te erret te zeze deri ne te zeze. Permbajne pikezime te vogla e te medha kromshpineliti. Ne disa vende vihen re pikezime te imta e cipa sulfuresh. Dunitet paraqiten te prekura nga serpentinizimi

*Serpentinitet;*

Serpentinitet takohen pothuajse ne te gjitha shfaqjet e kromit. Serpentinitet kane ngjyre jeshile e nga ndonjehere te zeze ne forme rreshpese, jane te pa qendrueshme, me teper takohen serpentinitet e formuara prej Harzburgiteve.

*Formimet Damarore;*

Ne formimet damaroje jane takuar keto lloje :

*Damaret e piroksenit*

Keta damare qe kane gjatesi nga disa dhjetra cm; deri ne disa metra dhe trashesi nga disa cm deri disa dhjetra cm.Keta damare kane drejtim te ndryshem dhe nderpresin shkembjenje rrethues.

*Damaret e gabrove, gabro pegmatiteve e te plagioklazeve.*

Keta me teper keto takohen ne pjesen veri – lindore te shfaqjes deri ne afersi te fshatit Voskopoje. Ato kane gjatesi nga disa metro e deri ne disa dhjetra metro, me trashesi nga disa cm deri ne disa dhjetra centimetro.

*Amfibolitet dhe seria efuzivo – sedimentare*


Amfibolitet dhe seria efuzivo – sedimentare e Katjel- Zona Minerare -690/6"" takohet ne juge te kesaj maje. Ajo perfaqesohet nga amfibolitet, shistet argilosilicore, ranore, diabaze te metamorfizuara qe ne pjesen me te madhe jane te shistezuara. Kane shtrirje veriperendim jugelindje, me renie te forte me tendence verilindje. Brenda amfiboliteve eshte takuar njje zone e ndryshuar dhe e oksiduar kapele hekuri, qe eshte ndjekur 150 – 200m ne shtrirje, me trashesi 3 – 4 metro.

*Depozitimet kuaternare (Q4 al)*

Keta formacione perfaqsohen nga copeza shkembore te shkembit meme shpesh te perzjera me dhera dhe copeza me te imta. Ato depozitohen kryesisht ne kuotat me te poshteme dhe ne gropat Jane formacione te tipit te deluvioneve dhe perhapen mbi shkembinje ultrabajke ne forme pullash te çrregullta me trashesi nga disa Cm deri ne disa dhjetra Cm. Prania e tyre favorizon zhvillimin e bimesise dhe vegjetacionit te paket qe eshte i pranishem ne pjeset mbi kodrat dhe malet e rajonit.

### *Ndertimi gjeologjik i vendburimit;*

Ne pikepamjen gjeologjike objekti ndodhet ne pjesen tektonike te shkembinjeve ofiolitike te masivit ultrabajzik te Shebenikut. Objekti i kromit “Katjel- Zona Minerare 690/6” ndodhet brenda formacioneve ofiolitike te masivit te Shebenikut, pjesa e qendrore e tij. Duke filluar nga poshte-lart ne ndertimin gjeologjik marin pjese keto formacione: Ne pjesen e poshtme kemi harzburgite te serpentinizuara deri ne pak te serpentiziua. Trashesia e ketyre formacioneve shkon mbi 1 km dhe perbejne bazamentin e zones se Katjel-Shebenik. Keta shkembinje jane mjaft te perhapur ne pjesen veriore te objektit duke ndertuar siperfaqe te tera. Si shkembinj keto i perkasin prerjes mantelike (niveleve te poshteme te prerjes). Perberja minerallogjike e tyre eshte mjaft e thjeshte olivine dhe piroksen rombik. Mbi harzburgitet kemi vendosjen e nje horizonti kalimtar.



*Figure 1: Harta Gjeologjike e zones se projektit*

### *Harcburgit-dunitik :*

Vendoset mbi horizontin e meposhtem. Tipar dallus e ketij horizonti jane shfaqja e dunateve te cilat fillojne ne linza te holla duke shkuar ne trashesi 20-30 metra ne pjesen e siperme te prerjes. Bien ne sy breznimet harzburgit – dunit me relieve negative tek dunitet dhe positive tek harzburgitet. Ne kete nivel te prerjes vendosen turpat kromifer te "Gobilles" etj. Trashesia e ketij horizonti krombajtes shkon nga 300 - 500ml ndersa ne shtrirje shkojne disa kilometra duke rujtur drejtimin e tyre strukturor Az shtrirje V-J dhe renie lindore me kend 65-700.

*Horizonti Harzburgit* - Dunit eshte me kryesoret ne pikepamjen e mineral mbajtjes. Pjesa kryesore e trupave te pasur te masivit te Shebenikut, vendosen ne kete nivel petrografik. Ne prerjen Menik - Katjel trashesia e ekspozuar e ketij niveli i kalon te 400ml, ku pjesa me e ngopur me dunate eshte ajo e Menikut.

### **1.1.2 Morfologja**

Morfologjia e trupave xeheror ne trajte pseudoplakore me shtrirje te qendrushme dhe renie me kend mbi 65 grad. Minerali per te cilen kerkohet leja e shfrytezimit eshte ai i kromit. Trupi i kromit ne objektin "Katjel- Zona Minerare 690/6" vendosen ne harzburgite te mbeshtjella nga nje kesishe e holle dunitike me trashesi e ndryshushme nga 0,4 deri ne 1,5 metra. Ne dyshemen e trupave kjo kesishe gjithmone eshte me e madhe se ne tavan te trupit. Trupat e kromit kane kalime graduale nga dunitet. Ne kunturet e tyre si ne tavan dhe dysheme kemi kalimin: Trup masiv - me pikezime – deri ne mbyllje gjenitike. E njejtë gje verehet dhe ne kunturet e shtrirjes, ne veri dhe ne jug, ku trupi krahes zvogelimit te trashesise, peson dhe varferim te Cr<sub>2</sub>O<sub>3</sub> deri ne mbyllje gjenitike. Trashesia e tyre ne objekt luhatet nga 0,4 meter deri ne 1,5ml (takuar ne galerine G-1(H-804ml). Trupat e kromit i perkasin tipit magnokromit, me krom te pasur te vendosur ne harzburgite me kesishe te holle dunitike.

### **1.1.3 Relievi**

Formacinet shkembore ultrabajzik kane kushtuar reliefin e kesaj zone me renie te bute, por vende-vende kemi dhe zona me relief jo shume te thepisur ku zhvillohet nje bimesi e paket. Objekti ndodhet ne relief kodrinor-malor me pranine e disa prroskave malore ne veri dhe jug te tij. Kuota me e ulet eshte e lumenit shkumbin dhe me e larta maja e Larte me kuote 1064ml. ku zhvillohet nje bimesi e paket (bushi).

### **1.1.4 Tokat**

Bazuar ne harte e kategorive te tokave ne Republiken e Shqiperise hartuar nga Instituti i Studimit te tokave, ne zonen e Bashkise Prrenjas gjenden pothuajse te gjitha tipet e tyre. Brezi i tokave te kafenja malore shtrihet ne pjeset me te uleta te maleve, nganjehere fillojne nga 300m mbi nivelin e detit dhe shfaqen ne lartesi deri ne 1000-1300m mbi nivelin e detit, shtrihen si ne brezin e shkurreve ashtu edhe te dushkut.

Brezi i tokave te kafenja pyjore, shtrihet ne brezin e ahut dhe te pishes, ne pjesen e mesit dhe te siperme te luginave lumore, duke zene lartesine nga 700-1699m mbi nivelin e detit. Brezi i

tokave kullote malore qe rrisin dhe zhvillojne brezin bimor te kullotave alpine, zakonisht vendosen mbi l 500-l 700m dhe ndodhet nen ndikimin e nje klime te ftohte dhe te ashper malore, te brezit te ahut, karakteristike per pllajat malore veriore.

Brezi i toka pyjore te kafenja eshte nje zone me toka qe permabajne me pak fosfor krahasuar me elementet e tjere dhe kryesisht perfaqesohet nga toka pyjore te kafenja, te cilat jane formuar sidomos nga magma ultra-alkaline TIC e shkembinj sedimentare. Ne baze te struktura kimike, tokat e zakonshme te tokave kafe pyjore kane reagim neutral me tendence aciditeti (pH 5,8-6,0), shkalle te larte te ngopjes me alkaline (90-95%), permabajtje te larte te humusit, azotit (humus 12 - 14%, azotit 1,08-0,48) e kalium.

Tokat pyjore kafe te pangopura alkaline jane formuar nga formacionet rerore dhe argjilore. Ato kane karakteristika te perbashketa me tokat e zakonshme pyjore, por ndryshojne prej tyre nga aciditeti, nga shkalla me e ulet e ngopjes me alkaline (20-25%) dhe nga pennbajtja ne sasi me te vogel te humusit (6-7 %) dhe azotit (0.35 %).

### **1.1.5 Ujërat**

Bazuar ne ndertimin gjeologjik dhe ujembajtjen, ne rajonin e Prrenjasit klasifikojme keto komplekse ujembajtese:

Kompleksi ujembajtes I shkembinjve te shkrifet - me ujembajtje mesatare

Kompleksi ujembajtes I shkembinjve kompakte, ku dallohen:

- a. Me ujembajtje mesatare deri te larte jo uniforme;
- b. Me ujembajtje mesatare;
- c. Me ujembajtje te ulet deri mesatare, jo uniforme;

Kompleksi ujmbajtes i shkembinejve praktikisht pa uje, ku dallohen:

- a. Shkembinje te shkrifet pa uje;
- b. Shkembinje kompakte pa uje;

### **Hidrografia**

Burimet hidrike te zones jane mjaft te pasura dhe te larmishme ne forme. Buri mi kryesor eshte rrjedha e siperme e shtratit te lumit Shkumbin qe formon dhe grabenen me tipike te zones. Se dyti ka mjaft burime ujore malore qe dergjen ne te dyja shpatet e kufizuese te lumit Shkumbin. Dhe se treti jane burimet ujore statike, pra liqenore (natyrore dhe artificiale) ku padyshim me te rendeshishme jane ato te liqeve te Rrajces, par edhe rezervuaret e krijuar krijojne mjedis me

impakt pozitiv mjedisor. Ujrat karakterizohen nga parametra fiziko-kimik dhe organoleptik te pershtashem per pirje por dhe per shfrytezim ne ekonomite e njesive te vleresuara sipas origjines se tyre.

Zonat natyrore te mbrojtur, ndodhen ne basenin uje mbledhes te lumit te Bushtrices, i cili ne kete zone ka prurje te medha, gjatesia totale mbrenda zones eshte 18,5 km dhe 7 km jashte saj deri sa derdhet ne Shkumbin. Ne zallin e lumit te krijuar nga gerryerja e tokes gjendet bimesia si rrapi dhe shelgu etj. Ajo qe e ben te vet; ante kete lume eshte prania e ujerave te pastra e te embela, duke krijuar ambientin e jeteses se Troftes (*Salmo trutta*) se malit dhe te Lunderzes (lutra). Te dyja speciet rrezikohen per t'u zhdukur ne kete zone. Perrenjte kryesore qe derdhen ne lumin e Bushtrices jane, perroi i Moraves, i Kunjit, perroi i Peshkut, perroi i Artinit, perroi i Skalaves dhe perroi i Shurit te Zi. Liqenet e Rrajces, ne Likopather.

#### Liqenet

Ne kete zone ndodhen 4 liqene ne shpatin lindor te malit te Shebenikut. Jane liqene te vendosur ne fundin e nje kompleksi akullnajor, ata jane te ndare njeri nga tjetri me depozitime moremike dhe shkembinje njerrezore. Thellesia e liqeneve shkon disa metra, ato kane uje te ftohte dhe shume te paster. Gjate dimrit liqenet ngrijne ne siperfaqe shtrese te forte akulli, mbi te cilen bie debora deri kur fillon shkrirja e akullit ne pranvere. Keto liqene kane bukurl te rralla natyrore. Tre liqene qe njihen me emrin liqenet e Rrajces kane siperfaqen me te madhe, ato ndodhen ne shpatin lindor te Shebenikut, poshte majes se Fursit. Nje nga speciet e rralla bimore Aster (*Lilium*) Albanicum qe gjendet vetem ne Shqiperi, pikerisht ne zonen e Rrajces, aty ku gjenden 16% te specieve bimore boterore.



Figure 2: Harta hidrologjike e zones se projektit

### **1.1.6 Klima**

Ne pikepamjen klimaterike zona e "Katjel- Zona Minerare -690/6" bene pjese ne nenzonen qendrore te zones klimatike malore. Dimri, per gjithesht, eshte i ashper dhe me lageshti, kurse vera eshte e nxehte dhe e thate. Kjo zone ka mbi 2500 ore ndriçim dielli ne vit. Muaji me ndriçim me te gjate eshte Korriku me 350 ore, kurse me ndriçimin me te shkurter eshte Dhjetori, me 108 ore.

Temperatura mesatare vjetore e ajrit eshte afersisht 13.8 grade celcius. Muaji me temperaturen mesatare me te larte eshte Gushti me 370 grade celcius, kurse ai me temperaturen me te ulet eshte Janari me -5 Ocelcius. Ne per gjithesi, ndryshimet mujore te temperatures jane graduale. Keto ndryshime jane me te medha kur kemi te bejme me ndryshimin e regjimit te stineve. Ky fenomen ndodh ne periudhat Mars – Prill dhe Tetor – Nentor, kur kemi perkatesisht kalimin nga rregjimi dimeror ne ate pranveror dhe nga rregjimi vjeshtor ne ate dimeror.

Vlera maksimale e temperatures se ajrit ne kete zone, me koeficient sigurie 50%, eshte rreth 37 grade celcius. Vlera e temperatures me te ulet minimale (-10 grade celcius), te rregjistruar ne kete zone, i perket dates 14 janar 1985. Mesatarja e sasise se reshjeve vjetore eshte rreth 1600 mm/vit. Sasia e reshjeve vjetore eshte shperndare ne menyre te çrregullt ne kohe.

Keshtu, ne periudhen Tetor-Maj, rregistrohen rreth 70 % e sasise se reshjeve vjetore. Muaji me i laget i viti eshte Nentori me 223 mm reshje, ndersa muaji Korrik eshte me i thati me rreth 59 mm. Drejtimet kryesore te ererave dominuese ne kete zone jane V-J dhe VP-JL.

### **1.2 Mjedisi biologjik**

Bashkia Prrenjas nga pikpamja mjedisore paraqitet me një biodiversitet shume te pasur tipike per zonat me klime mesdhetare kodrinore te perfaqesuar nga nenzona mesdhetare kodrinore qendrore, nenzona mesdhetare qendrore paramalore dhe nenzona mesdhetare malore.

Kushtet klimaterike, pedologjike dhe lartesia mbi nivelin e detit ndikojne ne larmishmerine morfologjike dhe strukturale te biodiversitetit, ekosistemeve, habitateve, peisazheve natyrore te hapesires se bashkise. Ky biodiversitet me tipik eshte ne njesite administrative te Rajces, stravaj dhe qukes, nderkohe qe eshte me i paket ne ish bashkine Prrenjas. Zona paraqet larmishmeri faune, shoqerimesh bimore, habitatesh, ekosistemesh, zona te mbrojtura, peisazhere, zona strikte, biomonumente, hidromonumente, gjeomonumente, etj. pra diversiteti natyror eshte i konsiderueshem dhe perben nje nga faktoret qe rrit ndjeshem atraksionin turistik te zones. Jo pak ndikim ne kete atraksion kane dhe vlerat historike e kulturore te zones, cka krijon nje si energji multifunksionale me impakt pozitiv te ndjeshem ne dinamiken e Bashkise dhe funksionalitetin e saj.

Pjese e konsiderueshme dhe me mjaft vlera natyrore dhe ekonomike eshte bimesia shkurro-drunore (sigurisht jo me pak e rendesishme eshte bimesia buqjesia, perimore, foragjere) e kultivuar si arrat (Gj. *Junglans*), Qershite (Gj. *Cerasus* sp.), shege (Gj. *Punica* sp.), mallet (Gj. *Malus* sp.), lajthite (Gj. *Corillus*), ftonjte (Gj. *Cidonia* sp.), dardhat (Gj. *Pirus* sp.), kumbullat (Gj. *Prunus*), hardhite (Gj. *Vitis* sp.), etj.

**Mjedisi biologjik eshte mjaft i pasur por per nga vlerat shkencore dhe rendesia citojme.**

-*Flora e zones tipizohet me lloje te tilla si:*

- *Aesculus hippocastanum* L (geshtenja e kalit) *Aconitum lamarcki* (Akoniti i Lamarkut)
- *Agrimonia eupatoria* (Rodheza)
- *Alyssum marcgraffi* (serica)
- *Dryopteris filin-max* (fier mashull)
- *Crocus cvijicji* (Shafrani i Cvijicit)
- *Crepis baldacci* (Krepi i Baldacit)
- *Chelidonium majus* (Latrapeci)
- *Betula pendula* (Meshtekna)
- *Fritillaria macedonia* (Fritillaria e maqedonise) *Juniperus oxycedrus* (dellinja e kuqe)
- *Juniperus com mun is* (dellinja e zeze)
- *Ulium albanicum*
- *Narthecium scardicum*
- *Nymphaea lutea* (Lekoni i Verdhe)
- *Numphaae alba* (lekoni i bardhe)
- *Ostrya carpinifolia*
- *Origanum vulgare* (Rigoni)
- *Oxitropus prenja*
- *Pinus heldreichi*
- *Pinus peuce* (rrobulli bardhe)
- *Picea exelsa* (Hormoqi)
- *Pinus sylvestris* (Hartina)
- *Pedicularis brachyodonta*
- *Salvia officinalis* (sherebela)
- *Ramonda serbica*
- *Sambucus nigra* (Shtogu)
- *Satureja montana* (Trumza)
- *Taxus baccata*
- *Tilia platyphyllos* (Blini)
- *Ulmus glabra* (Hithes)

- *Ulmus campestris* (Vidhi)
- *Viola ducaginica* shebenik
- *Valeriana officinalis* (Haraqine)
- *Viscum album* (Veshtull)
- *Vincetoxicum huteri* (Qenmbytese)

### **Shoqerime bimore karakteristike**

- *Festucopsis - Pinetum leucodermis*
- *Betuletum Albae*
- *Hypericetum Haplophilloides*
- *Leontopodietum Alpini*
- *Festuca paniculata - Lilium albanicum*
- *Myriophyllo - Nupharetum*
- *Gentiana lutea - Pinetum peucis*
- *Carpinus orientalis -Fraxinus ornus*
- *Populetum Tremula*
- *Fagus sylvatica -Sanicula europaea*
- *Juglando - Platanetum orientalis*
- *Juglando - Platanetum oriental is*
- *Fagus sylvatica - Galium odoratum*
- *Fagus sylvatica - Alli um ursinum*
- *Fagus sylvatica -Abies alba*
- **Hidromonumente**

Liqenet e Rrajces

### **Gjeomonumente**

- Sofra e Skenderbeut
- Shpella e Pishkashit Biomonumente

### **Biomonumente**

- Pylli i Stravajt
- Druri i Bizgaj (Stravaj)
- Rrapi i Berzeshtes
- Ahet e Fushe Gurres

Qendra e bashkise karakterizohet nga bimesia dekorative. Flora barishtore ne teresine e saj eshte mjaft e zhvilluar per shkak te kombinimit te faktoreve ekologjik, reshjeve, varacionit te temperaturave, pedologjise, etj.

Fauna eshte pasqyrim i gjendjes se flares dhe shoqerimeve bimore. Ne per gjithesi takohen larmishmeri gjitaresh por si me te rendesishem dhe qe duhen evidentuar per nga statusi permendim ariun (*Ursus arctos*), ujkun (*Canis lupus*), rreqebullin (*Felis lynx*), dhine e eger (*Rupicapra rupicapra*), derri (*Sus scrota*), lepur (*Lepus europeus*)<sup>11</sup> etj shpende te zonave kodrionore e malore, (Gj. *Accipiter*, Gj. *Corcus*, Gj. *Pirrohocvorax*, Gj. *Falco*, Gj. *Scrolopacides*, Gj. *Aquila*, Gj. *Alectoris*, Gj. *Hiudinidea*, etj) zvarrike te ndryshem, amfibe, etj. pra fauna eshte mjaft e pasur dhe atraktive.

Rrajca eshte zona e mbrojtur me forme glaciale te vendosur ne shpatin verior e lindor te malit te Shebenikut ku gjendet kompleksi i cirqeve akullnajore te Rrajces. Ne kete cirk akullnajor jane kater lfqene akullnajore, te cilet perbejne nje atraksion natyror per tu vizituar. Keto liqene kane nje gjatesi mesatare prej 100 metrash dhe nje gjeresi mesatare prej 80 metrash. Ato gjenden te vendosura ne lartesine 2.200 metra mbi nivelin e detit.

Zona e mbrojtur e Rrajces; ben pjese ne Parkun Kombetar, malor Shebenik-Jabllanice. Malet dhe kodrat e kesaj zone kane pak a shume te njejten lartesi mbi nivelin e detit, te cilat nderpriten nga disa perrenj e lugina, kjo ka bere qe terreni ne keto bjeshke te jete i thyer dhe mjaft i ashper. Zona natyrore e mbrojtur e Rrajces ka siperfaqe totale 4700 Ha. Larmishmeria e saj perbehet nga siperfaqe pyjore 3680 ha, siperfaqja kullosore 930 ha, siperfaqja ujore 10 ha dhe siperfaqja shkembore 80 ha. Zona e mbrojtur perfshin malin e Shebenikut dhe nje pjese te malit te Jabllanice-Belice te cilat nderpriten nga lumi ose perroi qe bashkon ujerat e ketyre bjeshkeve, keto ujera pasi gru mbullohen, kalojne poshte fshatit Bardhaj, ku devijojne dhe marrin drejtimin e Bushtrices ku behen pjese e lumit Shkumbin. Maja me e larte e zones ajo me kuote 2262 m e Reshpes, kuota 2251 m maja e Shebenikut, 2194 m-maja e Fursit, 2137 m maja e Dupkes, 2050 m-maja e Buturakut, dhe 2029 m-kuota me e ulet e perroit te Peshkut, e lugines se perroit te Artinit dhe lugina e perroit te Skalaves. Sipas studimeve gjeologjike zona e mbrojtur ben pjese ne zonen tektonike Gramoz-Mfrdite. Shkembinje kryesore jane serpentinitet dhe baziket qe bejne pjese ne masivin e Shebenikut, qe ndodhen ne anen e majte te tum it te Bush trices dhe gelqeroret, shkembinje sedimentare te masivit te Jabllanices, qe ndodhen ne anen e djathte te ketij lumi ose ne lindje te zones. Ne sasi te pakta ka dhe depozitime aluvionale.

### **1.3 Pershkrimi i cilesise se mjedisit dhe ndikimeve e mundeshme**

#### **1.3.1 Cilesia e ujrate**

Bashkia e Prrenjasit per vete reliefin karakterizohet nga siperfaqe ujore te konsiderueshme per shkak te prezences se lumit Shkumbin, por dhe te mjaft burime te tjera me te vogla qe rrjedhinnga shpatet formuese te tij, si dhe nga mjaft siperfaqe ujore natyrale te tipit karstik.

Hulumtimet konstatojne se siperfaqet ujore lijenore natyrale dhe artificiale kane nje trend ne rritje te shkalles se ndotjes se tyre. Kjo eshte e lidhur me:

- a. Menyren e menaxhimit te tyre spontan, pa kriteri hidroteknike.
- b. Nderhyrja antropogjene ne mjedisin kufizues duke shkatterruar zonat tampone te cilat shkarkojne me shume ndotes mekanik, kimik, organik, etj
- c. Mos krijimi i ba11ancave te duhura midis kapacitetit mbajtes, atij shfrytezues dhe efektit kohe.
- d. Nderhyrja ne mjedisin rrethues biologjik por dhe me gjere duke ndryshuar habitatin natyror dhe duke devijuar apo kanalizuar disa nga burlmet furnizuese.
- e. Zhvillimi i nje bujqesie agresive ne kimikate e pesticide, ka ka shtuar ne menyre te ndjeshme ngarkesen ujore ne nitrate, kimikate, pesticide, etj.
- f. Shtimi i fenomentit te erozionit ka shtuar depozitimet inerte ne siperfaqet ujore dhe eshte ekuilibruar ballanca aerobike·anaerobike duke stimuluar fenomenin e eutrofizimlt.
- g. Raporti midis qendrave te banuara dhe zonave ujembajtese eshte ne disfavor te cilesise se ujit per shkak te menyres se menaxhimit te veprimtarise urbane si rrjet kanalizimesh dhe perpunues.
- h. Menyra e shfrytezimit te minierave te Hekur Nikelit (Pishkash, Katjel, Skroske)
- i. Shkarkimet e pakontrolluara te ujrade te zeza dhe te perdonura nga zonat rurale qe kufizojne shtratin humor;
- j. Shkarkimet ilegale te mbetjeve te ngurta familjare, industriale, etj;
- k. Shfrytezimi per inerte ape faredolloj tjeter qe pakeson aftesine filtruese dhe zberthimin; biologjik, ka akumulon ndotje ne rrjedhje e meposhtme duke ndikuar ne iktiofaunen e tij.

Burimi kryesor eshte rrjedhja e siperme e shtratit te lumbit Shkumbin, qe formon dhe grabenen me tipike te zones. Se dyti, ka mjaft burime ujore malore qe dergjen ne te dyja shpatet e kufizuese te lumbit Shkumbin. Dhe se treti jane burimet ujore statike, pra lijenore ku padyshim me te rendesishme jane ato te liqeneve te Rrajces, rezervuare te dlat krijojne impakt pozitiv mjedisor. Ujrat karakterizohen nga parametra fiziko·kimik dhe organoleptik te pershtashem (te vleresuar ne burim) per pirje por dhe per shfrytezim ne ekonomite e njesive.

Metodologjia e analizes se gjendjes se trupit ujor eshte bazuar ne " forca shtytese • presione - gjendja - impakti - pergjigjet ( F SH P S I P ).

Sipas analizave te vleresimit te gjendjes se trupit ujor, kryesisht te lumbit Shkumbin qe perfaqueson arterien me te rendesishme por dhe fluentin ujembledhes te pothuajse

teresisehapesinore te bashkise rezulton se gjendja paraqitet si me poshte (pika e mionitoruar eshte ne Qukes):

- Permbatja e oksigenit te tretur 9.5 mg/l pra e cilesise se mire (norma >7).
- Permbatja e lendeve organike e shprehur ne nevoja biologjike per oksigen ose N B05 eshte shume e ulet dhe klasifikohet e cilesise se dyte.
- Permbatja e nevojes kimike per oksigen. NKO qe eshte tregues i ndotjes kimike dhe organike eshte 4.36 mg/l
- Permbatja e forforit total eshte 0.056mg/l duke qene vlore ne norme dhe ujrat konsiderohen te cilesise se mire.
- Permbatja e nitriteve eshte 0.004mg/l pra uje i cilesise shume te mire.
- Permbatja e NH4 (amoniakut) eshte 0.067, pra eshte uje i cilesise se dyte, gjendje e mire. Permbatja e nitrateve NO<sub>3</sub>, vleresohet i cilesise shume te mire nen normen e lejuar <0.8 mg/l.

Duke e marre piken monitoruese si pike fundore te bashkise lumi shkumbin ne kete segment konsiderohet i cilesise se dyte. Ndersa te gjitha burimet ujore te mesiperme vleresohen te cilesise se pare, pra shume te mire. Ujrat nentokesore jane me te ekspozuara potencialisht ndaj ndotesve per shkak te struktura gjeologjike, aftesise infiltruese, mungeses se shtreses ekranizuese, shkarkimeve urbane, buqesore dhe blegtoriale te pakontrollura por dhe te vendndodhjes se aktivitetave impaktuese pa studime hidrogjeologjike paraprake. Sipas analizave te elementeve kimik dhe anioneve e kationeve vleresuese ujrat nentokesore te zones konsiderohen shume te mire.

Ndotja ujore mund te jete e drejtperdrejte dhe e terthorte. Ndotja e drejtperdrejte ka te beje me shkarkimet direkt ne trupin ujor te ndotesve. Burimi kryesor i ndotjes se ujit mund te klasifikohet si i brendshem, industrial dhe agrikultural. I brendshem perfshin humbjet e ujerave nga shtepite dhe ndertesat komerciale.

Temperature e ujit ne lumin Shkumbin varion nga 25.2-26.8°C ne rrjedhjen e siperme dhe te poshtme ne muajin Korrik deri en 11.47- 16.45 °C ne Tetor. pH varion nga 7.85-8.75. Luhatjet stinore jane te vogla nga 0.04-0.9. Sipas direktives kuader te ujit per normat e lejuara te ujrate embla (pH= 6.5-8.5) konsiderohen ujra neutral me tendence alkaline.

### **1.3.2 Cilesia e ajrit**

Cilesia e ajrit eshte e lidhur drejtpereredrejti me shendetin e njerezve. Indikatoret e cilesise se ajrit jane grimcat e pluhurit (PM), qe jane perzierje aerosolesh te ngurta dhe/ose te lengta,. qe perfshijne nje diapazon te gjere ne grimca dhe perberje kimike, par praktikisht vleresohen PMIO

dhe PM2.S qe emetohen direkt si grimca primare ose formohen nga emetimet e 502, Nox, NH3, NMVOX.

Bashkia ne teresine e konfiguracionit te saj, karakerizohet nga parametra optimal te ajrit. Kjo eshte e lidhur me gjeografine, reliefin, klimen, biodiversitetin dhe impakti i ardhur nga veprimitaria jo eficiente e minierave aktuale ne shfrytezim. Sigurisht qe kryeqendra e bashkise ku eshte perqendruar aktiveti me i larte social ekonomik por dhe pozicionimi ne grabenen e kodrave rrethuese tregon nje cilesi te ajrit ne perkeqesim. Sipas hulumtimeve ne terren, mbeshtetur ne metoda alternative vleresimi apo duke perdorur njesi ekuivalente kohe/funksion rezulton se ne zonat rurale cilesia e ajrit eshte e mire dhe shume e mire. Praktikisht si burime ndotese te ajrit evidentohen ndertimet kryesish ne qytetin e Prrenjasit dhe ne zonat me aktivitet ekonomik, por zjarret e shumta dhe te pakontrolluara. Problematike paraqet mungesa e infrastruktures rrugore (sidomos ne zonat rurale me rruge te pa asfaltuara) ku ngrihen sasira te konsiderueshme pluhuri. Por shqetesim per cilesine e ajrit perbejne dhe perdorimi i mjeteve motorike te amortizuara qe emetojne sasira te konsiderueshme gazesh. Me problematike eshte zona e aksit nacional qe pershon qytetin e Prrenjasit ku tejkaloqet numri i diteve sipas standartit ditor te BE {SO<sub>2</sub>µg/m<sup>3</sup>} dhe ku numri i diteve te lejuara eshte 35. Te lidhur me faktoret e sipercituar jo shume e mire ne zonat urbane eshte dhe gjendja e N02, 502, 03, CO dhe BTEX. Por kryesish ndotes te ajrit me keto komponime apo element jane makinat, zjarret, djegja e biomasave, djegje e mbeturinave ne vend depozitime hapsinore apo kazanet e grumbullimit, pluhra dheu dhe ndertimet. Vleresohet se si ndotes real per tu vleresuar dhe konsideruar problematik jane PM10, PM2,5 dhe 502 te lidhura me burimet gjeneruese dhe mungenen e masave alternative sikurse eshte pastertia dhe gjelberimi i paket ne pikat e cituara.

### **1.3.3. Zhurmat**

Efektet e zhurmave pasqyrohen ne sjellje dhe shendetin human por dhe me gjere te mjedisit biologjik. Ndotja akustike shkakton demtime fiziologjike, akustike, agresivitet, stres, shqetesimi gjumi, humbje degjimi, ndryshim sjellje riprodhuese apo ushqyese ne faune.

Shqetesim burimi i zhurmave perben per qendren e bashkise ku gjenerohen nga industria ndertimore, sistemi i transportit, gjendja e mjeteve motorike, lokalet etj. Nderkohe qe nje burim real sidomos per biodiversitetin dhe koridoret biologjike eshte aksi i korridorit 8, qe gjeneron zhurma te ndjeshme. Problemi behet i ndjeshem per faktin e prezences se zhurmave ne intervalin dite/nate dhe tejkalimi i kufirit te BE (55/45 dB). Ne zonat rurale situata akustike eshte shume me e mire. Si problematike paraqiten sharrat te cilat nuk respektojne kerkesat ligjore (kujtojme se disa nga keto veprojne apriori ligjt) duke ndikuar ne regjimin faunistik me pasoj shqetesime me te ndjeshme riprodhuese ose duke operuar ne biokoridoret.

#### **1.3.4. Administrimi i mbetjeve**

Menaxhimi i mbetjeve ka te bez me pakesimin e gjenerimit te tyre ne origjine, ricklimin, menyren e grumbullimit dhe te trajtimit sipas tipologjise se tyre. Ky perfaqeson nje nga problemet me serioze per kryeqendren e bashkise por dhe per njesite administrative te cilat kane shtrirje shume te madhe dhe praktikisht nuk mund te kriohet lehte nje sistem i integruar i menaxhimit te tyre. Problemi ne planin organizativ dhe realizues eshte me i thjeshte ne kryeqendren e bashkise dhe ne disa fshatra perreth me urbanizim me te koncentruar. Fakti i gjenerimit te tyre me tipologji heterogjene, grumbullimi i padiferencuar, mos menaxhimi i sistemit te grumbullimit, transportit dhe trajtimit, shkakton impakt te ndjeshem mjedisor per komuniteten dhe mjedisin ne teresi. Vleresohet se mesatarisht gjenerohen 395kg/banor/vit, duke gjeneruar 3 300 000 kg/vit, 'ka mos menaxhimi i duhur shkakton depozitime te pakontrolluara, kontaminime, ndikim ne parametrat e ajrit dhe ne teresi ne shendetin e njerezve. Problematika e konstatuar ka te bez me faktin se mbetjet nuk differencozen, grumbullohen ne kosha jo te mirembajtur dhe mund te qendrojne relativisht gjate ne to duke ndikuar ne cilesine e ajrit, me menyren e transporti dhe venddepozitimin e tyre si dhe me pas me perpunimin e thjeshte mekanik te mbulimit pa asnje lloj trajtimi. Nderkohe qe per njesite administrative hedhja e tyre behet pothuajse teresisht spontane.

*Tipologjia e mbetjeve te ngurta te produhuara eshte:*

- Mbetje shtepiake
- Mbetje sanitare
- Mbetje industriale
- Mbetje ndertimore

Ne kryeqendren e Bashkise vellimi i mbetjeve tejkalon kapacitetin e lejuar nderkohe qe ne zonat rurale shkakton tjetersim estetik te peisazhit perpos pasojaqe qe vijne si rezultat i pamundesise se biodegradimit natyral.

Mbetjet ekzistuese perbejne rrezik per:

- Ndotjen e ujrave netokesore;
- Emetimin e gazrave te demshme me efekt sere;
- Behen burim i semundjeve dhe epidemive;
- Tjetersojne peisazhin;

## **2. PERSHKRIMI I PROJEKTIT**

### **2.1 Qellimi i Projektit**

Projekti i hartuar ka per qellim studimin e mundesisë së shfrytëzimit të mineralit te kromit në zonen minerare nr. 690/6, objekti "Katjel" me vndodhje ne fshatin Rajce Fushe, Njësia Administrative Rajce, Bashkia Prrenjas, Qarku Elbasan, nga subjekti privat "MINERALUNIT" shpk.

Zona Minerare, objekti "Katjel", ka një sipërfaqe prej:  $S = 0.108 \text{ km}^2$ .

Minerali i kromit do pasurohet ne fabriken e pasurimit ekzistuese dhe do te tregtohet per prodhim ferro kromi ne tregun e brendshem ose do eksportohet ne tregun e jashtem.

Punimet e hapjes perqatitjes dhe shfrytezimi te mineralit do te behen ne zbatim te studimit teknikoeconomik dhe projektit te shfrytezimit, te miratuar ne keshillin teknik te AKBN duke zbatuar teknologji bashkekohore.

### **2.2 Mënyra e shfrytëzimit**

Për të përcaktuar mënyrën e shfrytëzimit u morën në konsideratë këta elementë:

- topografia e zonës së projektit,
- sasia e rezervave të shfrytëzueshme,
- karakteristikat gjeomekanike të shkëmbinjve,
- elementët e shtruarjes dhe
- koeficienti i zbulimit,

Nga analiza e këtyre faktorëve është parashikuar shfrytëzimi me karrierë i rezervave të llogaritura të objektit.

Gjithashtu, shfrytëzimi me karrierë ne qill te hapur favorizohet dhe nga:

- Rënia e formacioneve, që ndërtojnë pakon produktive në drejtim të tillë që lejojnë zhvillimin normal të shkallevë dhe elemeteve të tyre pa sjellë kushtëzime teknike. (në drejtim të kundërt me terenit me një kënd);
- Eksperiencia e shfrytëzimit në vitet të kaluara, ka treguara se elementët e shtruarjes së formacioneve te mineralit te kromit dhe karakteristikat gjeomekanike të tyre favorizojnë kendet e mëdha të skrapatave dhe nuk sjellin asnjë rrezik rrëshqitje;
- Hidrogarfia e zones, ne per gjithesi dhe teritori projektuar per leje minerare ne veçanti, nuk pritet te krijojë probleme për shfrytezimin e vendburimit, mbasi siperfaqja eshte plotesisht e drenuara dhe nuk ka probleme ujtrash dhe burimesh te pranishme ne te .
- Koeficjenti i zbulimit ne masen e pakonsiderueshme, ne saj te cilit nuk ka nevoja per siperfaqe te depozitimit te perhershëm ose te perkohshëm te sterileve.

## **2.3 Regjimi i punës**

Per realizimin e prodhimit te parshikuar karriera do te punoje 12 muaj, 20 dite ne muaj me nje nderese ne dite dhe me 8 ore pune /turne. Ne ditet me lageshti ne per gjithesi nuk do te punohet.

## **2.4 Variantet e hapjes së vendburimit dhe argumentimi dhe zgjedhja e mënyrës së hapjes**

Vendburimi do te hapet nga rruga ekzistuese qe pershon vendburimin ne pjesen jugore dhe perendimore.

Në studimin e varianteve të hapjes së vendburimit, janë marrë në konsideratë:

- Kuota e poshtëm e rrugës ekzistuese;
- Kuota e sipërme e zonës së shfrytëzimit;
- Parametrat gjeometrike të zonës së shfrytëzimit si:
  - + Gjerësia e karrierës në plan në pjesën e sipërme të saj;
  - + Gjërësia në sheshin e poshtëm të karrierës;
  - + Gjatësia e karrierës në pjesën e sipërme;
  - + Gjatësia e karrierës në pjesën e poshtme;
- Shpërndarjen e rezervave të nxjerrëshme në shkallë në raport me sasinë e përgjithëshme të rezervave, si në tabelën më sipër.
- Pjerrësinë mesatare më të madhe dhe më të vogël të sipërfaqes së objektit dhe asaj jashtë kufijve të saj.
- Lidhja me rrugë nga ana jug perendimore të karrierës.

Mundësine e lidhjes me rrugë të pjesës së sipërme të karrierës dhe të pjesës së poshtëme të karrierës ose duke përdorur zonë e shfrytëzuar në vitet e mëparëshm.

## **2.5 Sistemi i shfrytëzimit treguesit tekniko-ekonomikë të tyre**

Në zgjedhjen e sistemit të shfrytëzimit janë marrë parasysh faktorët e mëposhtëm:

- Mënyra e ngarkimit dhe transportit të sterilit.
- Mënyra e kryerjes së punimeve të zbulimit.
- Mënyra e ngarkimit dhe transportit të mineralit te kromit në brendësi të karrierës dhe jashtë saj.

Ngarkimi i mineralit te kromit në sheshet e shkallëve të shfrytëzimit parshikohet të kryet me eskavator me kovë;  $V_{kov} = 2 \text{ m}^3$ . Eskavatori që disponon firma është i pajisur me kovë pér dhera dhe pér shkëmbinjtë.

Në përgjithësi, gjatë shfrytëzimit të karrierës, me përjashtim të rasteve të veçanta, do të ketë transport me kamionë në një distance te shkurter.

Sistemi i shfrytëzimit që parashikohet të perdoret është i thjeshtë me transport të sterilit brenda karrierës në distancë 50 deri 550 m.

## **2.6 Elementet e sistemit te shfrytezimit qe parashikohet te perdoret ne kete objekt jane:**

- Lartesia e shkalles se karrieres eshte 10m
- Gjeresia e sheshit te punes nga 8-12 m ne 20-40-50m
- Kendi i skarpates se shkalles 73o
- Kendi i sharjes se skarpates se shkalles 63o
- Gjeresia e shesheve perfundimtare te shkalleve 4 m
- Ngarkimi dhe transporti i mekanizuar;

Rezimi i shkembit rrethues dhe mineralit do te behet me lendese plaseze te vendosur ne bira marteli dhe bira sonde.

## **2.7 Rradha dhe drejtimi i shfrytëzimit**

Shfrytezimi i vendburimit do te behet nga larte-poshte me shkalle te pare duke u ulur deri ne shkallen fundore. Drejtimi shfrytezimit do te jete nga lindja ne perendim. Orjentimi i pergjithshem i shkalleve do te jete sipas izohipseve te terenit. (shih planimetrine e karrieres ne gjendjen perfundimtare)

Per realizime sasise se prodhimit te parashikuar ne projektin e shfrytezimit te ketij objekti eshte parashikuar qe shfrytezimi te kryhet me gjashte shkalle. Per krijimin e kushteve per nje pune normale ne karriere eshte parashikuar qe ne vitin e pare te behen hapja e karrieres dhe ndertimi objekteve ndihmese.

## **2.8 Mënyrat e rrëzimit të mineralit te kromit në karriërë**

Coptimi i shkembit ne karjere eshte projektuar te behet me keto metoda:

1-Me matrapik te vendosur ne eskavator.

2-Me lende plaseze te vendosur ne bira sonde ose marteli

Coptimi me matrapik do te perdoret kryesisht per thyerjen e copave te medha te shkembit ose kromit, hapjen e rrugeve te karrieres, punimeve perqatitore, shesheve te punes, etj.

## **2.9 Rrëzimi i mineralit te kromit në shkallët e karrierës me lëndë plasëse me bira sonde**

Per shpimin e birave ne sheshet e shkallev te karjeres projektuar per shfrytezim me rrezistence ne shtypje  $200 \text{ kg/cm}^2$ , perdoret makine shpimi vet – levizese mbi zinxhira te produara nga uzinat TAMRROK ose “ATLAS COPCO”, me instrument çpimi ne fundin e biros, me koke çpimi 89mm.

Tipet e sondave qe rekomandojme shpojne bira me diameter 89 mm-220 mm, me thellesi maksimale 30 m, kend çpimi mbi 1350, me gjatesi shtange çpimi 4 m, diameter shtange 76 mm, montim cmontim, ndrrim ne menyre te mekanizuar te tubacioneve, me kapje te pluhurit me sistem respiratori

- Sasia e ajrit te Prodhuar nga kompresori  $21 \text{ m}^3/\text{minut}$
- Presioni ajrit 14 bar
- Shpejtesi shpimi  $0.3\text{ml}/\text{minut}$

## **2.10 Elementet teknik te frontit te punes ne karrjere**

H – Lartesia e shkalles = 10 m.

B – Gjatesia e frontit te shkalles per nje shperthim pranohet me projekt 30m ne vartesi te gjatesis se shkalles dhe kerkesave per prodhim.

d – Diametri i biros se sondes = 98 mm.

$\alpha$  – Pjerresia e skarpates se shkalles e pjerresi 65 grade.

m- Pjerresia e birave paralel e faqet e skarpates se shkalles.

n- Numri rreshtave ne nje shperthim 1ose 2.

e- Tipi lendet plaseze ANFO

Kur pjerresia e skarpates se shkalles eshte me e vogel se 700 birat e sondes behen te pjerrta paralel me faqet e skarpates. Skrapatat e shkalles ku do behet shpimi birave dhe shperthimi ngarkesave me lende plaseze me projekt do te jene te pjerrta, me kend renie 650.

Numri i rreshtave ne shkalle merret ne varesi te gjerisise se sheshit te siper te shkalles dhe kerkesave per prodhim. Ne rastin konkret projekti parashikon 1 ose dy rreshta birash.

### 3. ANALIZA E NDIKIMEVE TË MUNDSHME SOCIALE DHE NË MJEDIS

Analiza e ndikimeve shërben për të parashikuar ndikimet e mundshme të projektit në mjedis si dhe vlerësuar shkallën/rëndësinë apo madhësinë e tyre në raport me vlerat mjedisore që dëmtohen nga ndikimet. Rëndësia e çdo ndikimi apo pasoja e tij në receptorin apo zonën e ndikuar është vlerësuar dhe kategorizuar bazuar në probabilitetin që ndikimi të ndodhë, llojin i ndikimit, kohëzgjatjen e ndikimit, shkallën e ndikimit dhe mundësinë për të zbutur pasojet e ndikimit.

<b>Operacioni i punës</b>	<b>Pasoja në receptor</b>
Gërmimi i shtresave të tokës për nxjerrjen e mineralit te kromit	<p><b>Tokë</b></p> <p>Ndryshim i destinacionit të përdorimit të tokës në një sipërfaqe prej <math>0.108 \text{ km}^2</math>;  Shqetësim i shtresës së tokës dhe dëmtim i strukturës së saj. Ndikim në zhvillimin e proceseve të tokëformimit etj. në sipërfaqen e prekur;  Humbje në pjerrësinë e tokës pasi këndi i shkallëve të karrierës është më i madh nga pjerrësia natyrale e terrenit;  Erozion në kohë me reshje në shkallët e karrierës.</p> <p><b>Ajër</b></p> <p>Gjenerim i një sasie pluhuri, ndikim i cili do të jetë më i ndjeshëm në stinën e thatë;  Duke qenë se të gjitha mjetet dhe makineritë që do të përdoren në karrierë janë me motor me djegie të brendshme, do të emetohen në ajër sasi të caktuara të gazeve të djegies si <math>\text{NO}_x</math> dhe <math>\text{SO}_x</math>;  Emetim i zhurmave nga perdorimi I mijeteve te punes.</p> <p><b>Uji</b></p> <p>Avaritë e mekanikës mund të bëhen shkak për rrjedhje aksidentale lubrifikantësh dhe karburantesh, të cilët nën veprimin e ujrave të shiut mund të shkaktojnë ndotje të ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësorë.</p> <p><b>Biodiversiteti</b></p> <p>Emetimi i pluhurit mund të ndikojë në bimësinë e zonës përreth, ndërsa zhurma dhe vibracioni mund të shqetësojnë dhe mbajnë larg faunën.</p>
Përdorimi i lëndëve plasëse	<p><b>Tokë</b></p> <p>Dëmtim i strukturës së tokës dhe shtresës sipërfaqësore të saj deri në kapjen e bloqeve të mineralit te kromit</p> <p><b>Ajër</b></p> <p>Gjenerim i sasive të pluhurit, çirim zhurmash dhe vibracione. Njëkohësisht mund të ketë emetime gazesh, por të gjitha këto ndikime janë minimale për shkak të karakteristikave të zonës ku do</p>

	<p>të zbatohet projekti (rurale dhe larg qendrave të banuara).</p> <p><b><i>Uji</i></b></p> <p>Shperthimet e pakontrolluara mund te shkaktojne rreshqitje te masave ne trupat ujore ne afersi te karrieres siperfaquesore.</p> <p><b><i>Biodiversiteti</i></b></p> <p>Emetimi i pluhurit mund të ndikojë në bimësinë e zonës përreth, ndërsa zhurma dhe vibracioni mund të shqetësojnë dhe mbajnë larg faunën.</p>
Përdorimi i mekanikës dhe automjeteve të transportit	<p><b><i>Tokë</i></b></p> <p>Ngjeshje e mundshme e shtresës së tokës nga automjetet që do të lëvizin në objekt. Do të tregohet kujdes që të mos përdoren hapsira të virgjëra (të pashkelura) nëse nuk është e nevojshme.</p> <p>Si pasojë e ndonjë avarie ose dëmtimi të eskavatorit dhe mjeteve të transportit mund të ketë rrjedhje të lubrifikanenteve në tokë, e për pasojë ndotje të saj.</p> <p><b><i>Ajër</i></b></p> <p>Mund të gjenerohet një sasi pluhuri si rezultat i qarkullimit të kamionëve në objekt. Pluhuri do të jetë më shumë i pranishëm në mot të thatë por do të tregohet kujdes sa i takon shpejtësisë së lëvizjes së makinave dhe larjes së tyre;</p> <p>Do të ketë gjenerim zhurmash dhe aromash nga djegia e karburanteve. Si rezultat i këtij procesi të fundit do të ketë edhe çlirime gazesh, por duke patur parasysh karakteristikat e zonës (jo e banuar, rurale etj.) ndikimi do të jetë mjaftueshëm larg vlerave limit të lejuara.</p> <p><b><i>Uji</i></b></p> <p>Avaritë e mekanikës mund të bëhen shkak për rrjedhje lubrifikantësh dhe karburantesh, të cilët nën veprimin e ujrave të shiut mund të shkaktojnë ndotje të ujërave sipërfaqësorë dhe nëntokësorë.</p> <p><b><i>Biodiversitet</i></b></p> <p>Gjenerimi i zhurmave mund të shqetësojë disa lloje faunistike të zonës.</p>
Aktiviteti njerëzor	Gjenerim i mbetjeve urbane dhe ambalazhet e ndryshme si kartona, bidona dhe qese plastike. Do të merren masa që këto mbetje të depozitoohen në vendin e parashikuar nga pushteti vendore.

#### **4. PROGRAMI I MONITORIMIT TË NDIKIMEVE NË MJEDIS GJATË ZBATIMIT TË PROJEKTIT**

Në përgatitjen e programit të monitorimit është menduar që të përzgjidhen për t'u monitoruar nga vetë kompania ata elementë që realisht mund të identifikohen, maten, regjistrohen dhe komunikohen në organet e administrimit të mjedisit (DRM). Të dhënët cilësore, sipas tabelës do të hidhen në një regjistër që administrohet nga vetë kompania dhe do të dorëzohen në DRM-në e qarkut sa herë të kërkohet, sipas procedurave ligjore dhe rregulloreve. Më poshtë jepen disa indikatorë të cilët duhen monitoruar për të vlerësuar suksesin dhe matur realizimin e objektivave mjedisore të projektit. Interpretimi i një gjendje të caktuar mjedisore duhet bërë në lidhje të ngushtë me fazën në të cilën gjendet zbatimi i projektit. Duhet kuptuar se një gjendje e përkeqësuar e mjedisit në një fazë të caktuar të zbatimit e cila është fazë tranzitore dhe jo tregues absolut i realizimit të objektivave të projektit.

Tabela 1: Elementët e monitorimit të aktivitetit

Nr	Elementi i monitorimit	Frekuanca	Shpjegim
1.	Monitorim i gjendjes së mekanikës	Vazhdueshëm	
2.	Monitorim i funksionimit të kanalit perimetrik dhe kontrollit të ujërave të shiut	Vazhdueshëm	
3.	Monitorimi i ngritjes së pluhurave në objekt dhe gjatë transportit	Vazhdueshëm	
4.	Sasitë e karburanteve që përdoren	Çdo javë	
5.	Monitorim i shperthimeve me lenden plasese	Vazhdueshëm	
6.	Monitorim i faktorëve që shkaktojnë rrezik në objekt	Vazhdueshëm	Gjendja e shkëmbit, tokës, mekanikës
7.	Monitorim i të gjithë masave të parashikuara për zbutjen e ndikimeve	Periodik	Do të bëhen analiza dhe shqyrtim të efektivitetit të masave të marra
8.	Ecuria e zbatimit të planit në përgjithësi	Vazhdueshëm	
9.	Monitorimi i gjendjes së dheut dhe masave inxhinierike të rehabilitimit në çdo shkallë	Vazhdueshëm	

10.	Monitorimi i zhvillimit të bimësisë së mbjellë	Periodik	
11.	Monitorimi i bimësisë spontane që do të zhvillohet natyrshëm në zonën e rehabilituar	Periodik	
12.	Monitorimi i zhvillimit të faunës në zonën e rehabilituar	Periodik	
13.	Monitorimi i tregueseve të gjendjes së tokës si lënda ushqyese, lagështia etj.	Periodik	

Efikasiteti i masave të Planit të Menaxhimit do të vlerësohet nga rezultatet e tij konkrete në terren nëpërmjet monitorimit të vazhdueshëm. Plani i Menaxhimit do të përmiresohet dhe përshtatet në të ardhmen në varësi të kërkesave praktike.

## 5. NDIKIMET POZITIVE NE MJEDISIN E ZONES SE PROJEKTIT

### Ndikimet kryesore pozitive

- Duke qenë një aktivitet i ri ekonomik, ai do të kontribuojë në gjenerim të ardhurash të reja për administratën vendore nëpërmjet futjes në sistemin e taksave.
- Kompania do te mirembaje rrugen egzistuese.
- Së fundmi kompani do te shikoj mundesine e punesimit te banoreve te zones si roje objekti.

## 6. PLANI I MASAVE PËR ZBUTJEN E NDIKIMEVE TË IDENTIFIKUARA (PMM)

Masat kryesore të propozuara adresojnë zgjidhje të mundshme dhe të përshtatshme për minimizimin e ndikimeve të mundshme negative në mëdisë të zhvillimit të veprimtarisë.

Lloji i ndikimit	Masat	Komenti për eficencën
Gërmim i shtresave të tokës	Piketim i saktë i sipërfaqes që nevojitet dhe do të shfrytëzohet	Ndikimi mbahet brenda kufijve natyralë të tij
Humbje e pjerrësisë së tokës sepse këndi i shkallëve është më i madh se pjerrësia natyrale e terrenit	Në projekt pjerrësia e skrapatave të shkallëve është parashikuar të jetë $70^\circ$ . Kjo pjerrësi është më e madhe se ajo natyrale e terrenit në të cilin gjendet objekti. Mbas sistemimit përfundimtar dhe mbushjes do të tentohet që ajo të ulet edhe $10^\circ$ të tjera.	
Gjenerimi i dherave sterileve nga procesi i hapjes së shkallëve.	Nuk ekzistojnë masa efikase përvèç të përzgjidhet zona më e përshtatshme dhe pa patur nevojë për shumë ndërhyrje.	Masa e dheut që duhet lëvizur është tashmë e përcaktuar nga teknika e shfrytëzimit dhe nuk mund të pakësohet volumi i dherave.
Emetim zhurmash, gazesh, vibration dhe pluhuri	Planifikim paraprak i punës dhe kohëzgjatje sa më e ulët e realizimit të shpërthimeve. Transporti i sterileve do të bëhet me kamionë të mbuluar.	Do të ulet kohëzgjatja e ndikimit
Ngjeshje e pjesshme e tokës nga lëvizja e automjeteve të transportit	Lëvizje dhe parkim i kamionëve vetëm brenda zonave të caktuara	Ndikimi zbutet brenda mundësive dhe nuk shtrihet më shumë se ç'është planifikuar
Erozion në kohë me reshje	Hapje e kanalit perimetrik përgjatë transhesë kryesore të karrierës për mbledhjen e ujrave të shiut dhe drejtimi i tyre për në rezervuarin në nivelin më të poshtëm të saj. Në nivelin më të poshtëm, mund të krijohet një rezervuar i vogël që do të mbledhë ujrat e shiut me qëllim dekantimin e tyre para shkarkimit në mëdis. Kanalet rrugës do të drejtohen në mënyrë të tillë që të shkarkojnë në këtë ujëmbledhës, i cili do të vazhdojë të shërbejë edhe në fazën e rehabilitimit, si burim ujor, pasi në zonë nuk evidentohen burime natyralë	Mbajtje e ndikimit brenda kufijve të origjinës

Ndotje e tokës si pasojë e avarive të mekanikës	Kontroll paraprak dhe periodik i vazhdueshëm i makinerive	Është masë e sigurt parandaluese përvèç rr Ethanave të veçanta dhe avari të papritura
Ndotje e ujrave sipërfaqësorë me lubrifikantë	Kontroll paraprak i makinerive dhe periodik i vazhdueshëm	Është masë e sigurt parandaluese përvèç rr Ethanave të veçanta dhe avari të papritura
Ndotje e ujrave sipërfaqësorë nga rreshqitja e masave te sterileve dherave	Kryerja e shperthimeve te kontrolluara nga staf i specializuar dhe i licensuar.  Depozitimi i sterileve dherave të shkrifët përkohësisht në sipërfaqet e parashikuara në projekt.	Shperthimet e kontrolluara shmangin vibrimet me inesitet te larte dhe rrezimin e mineralit brenda zones minerare. Shmang perhapjen kaotike te dherava dhe sterileve te cilat ne veprimin e reshjeve atmosferike mund te shkojne ne keto ujra
Ndikime në pejsazh, gjeologjinë topografinë zonës	në dhe e Ky ndikim është i pamshmangshëm por do të merren masa për të mbajtur ndikimin brenda sipërfaqes dhe për të ruajtur profilin gjeometrik të karrires me qëllim që të mundësohet rehabilitimi. Duhet bërë kujdes të ruhet uniteti hapsinor i sipërfaqes dhe ndërlidhja e proceseve mjedisore dhe bashkëveprimi i elementeve midis tyre (uji, toka, bima)	
Ndikime në botën e gjallë	Puna do të jetë e organizuar me një turn, duke mënjanuar orët e papërshtatshme të punës. Mbasi të bëhet inspektimi i objektit para fillimit të operacioneve dhe monitorimi i vazhdueshëm gjatë fazës së zbulimit, do të analizohet me kujdes sjellja më e mirë ndaj botës së gjallë, si p.sh. të ndërpriten punimet në fazë të caktuara të ciklit vjetor të zhvillimit të biodiversitetit.	Vlerësime më të sakta për masat e duhura do të jepen në vitin e dytë mbas monitorimit të biodiveristetit në zonë gjatë vitit të parë të veprimtarisë. Një teknikë e vlerësuar efikase do të aplikohet për zvarranikët në fazën e rehabilitimit duke gdhendur faqet e skarpatës së shkallëve dhe krijuar rrugë për lëvizjen normale të tyre nëpër karrierë. Këto ulluqe do të shërbejnë edhe për komunikimin e tyre dhe lëvizjen e ujërave

